



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u bazuar në nenin 17 shkronja k) dhe s) si dhe nenin 40 shkronja c) dhe l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040. Nenin 10 pika 4. Dhe nenin 40 pika 3. të statutit të Komunës së Klinës, Ligjin Për Procedurën e Përgjithëshme Administrative nr.05/L-031. Nenin 2 të Ligjit Për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049. Nenin 57 dhe 58 të Ligjit për Menagjimin e Financave dhe Përgjegjësitë 03/L-048. Kërkesën e e parashtuar nga drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim me nr prot. 01Nr.434-40580 të datës 29.11.2023 si dhe me Rekomandimet e Komitetit për Politik dhe Financa të datës 08.12.2023, Kuvendi i Komunës së Klinës në mbledhjen e XI-të të rregullt për vitin 2023 të mbajtur me datë 22.12.2023 mori:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtoris për Financa Ekonomi dhe Zhvillim për faleje të qiras komunale për vitin 2023 për kategorit e dala nga lufta e UÇK-së, banuesit social, shfrytëzuesit e lokaleve afariste dhe borxhin e akumuluar ndër vite për shfrytëzimin e hapësirave publike.
2. Nga falja e qiras komunale si në pikën 1 të këtij vendimi, do të përfitojnë të gjithë banuesit të cilet shfrytëzojnë banesat të cilat janë në pronësi të Komunës së Klinës, shfrytëzuesit e lokaleve afariste të cilat janë në pronësi të Komunës së Klinës, ndërsa falet tërësisht borxhi i akumuluar ndër vite për shfrytëzimin e hapësirave publike.
3. Kusht për të përfituar nga falja e qiras komunale për vitin 2023 është pagesa e borxhit të akumuluar ndër vite, ndërsa ata të cilet kanë qenë pagues të rregullt të qirasë, do të kalojnë në parapagim për vitin 2024.
4. Për zbatimin e vendimit do të përkujdeset, Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa Ekonomi dhe Zhvillim.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-43414 / 2023
Klinë, më 28.12 / 2023



Kryesuesi,
Fadil Gashi